


Më 12 - 03 - 2018 NË EMËR TË POPULLIT
 

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM DIVIZIONI PENAL**, si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi si dhe me procesmbajtësen Kadishe Shabani, zyrtare ligjore, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] K. Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/IL.nr.2167-2/16 të datës 19.04.2017, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Sebahate Sinani si dhe të akuzuarit [REDACTED], pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 04.01.2018 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 11.01.2018 përpiloi me shkrim këtë:

#### AKT GJYKIM

I akuzuari: [REDACTED] i lindur me dt [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], me vendbanim në Fshatin [REDACTED] K. Ferizaj, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal [REDACTED]

#### ËSHTË FAJTOR

Se me datë 11.11.2016, rreth orës 16:00, në pyllin publik, në vendin e quajtur "Ngastra 61" në Rajonin Ekonomiko Pyjor, Neredime-Jezerce, me qellim vjedhje është takuar duke prere kater /4/ cope trungje te ahut e te njohëm, me diametër 40-50 cm, me vëllim të përgjithshëm prej 5.33 metra kub, në vlere prej 719.55 euro /shtatëqind e nëntëmbëdhjetë e pesëdhjetë e pesë cent/, drutë kanë qenë të prera me sharrë motorrike dhe të transportuar me traktor të markës IMT.

me të cilën kreu veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit të sipërcituar dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

### GJYKON

- **ME DËNIM GJOBË NË LARTESI PREJ 200 euro /dy qind/, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prere.**

Dhe

- **ME DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ 4 /katër/ Muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet brenda 1 /një/ Viti, nëse i pandehuri nuk kryen veper tjeter penale, pasi aktgjykimi të merr formën e prere.**
- Nëse dënimi i zëvendësuar me gjobe nuk mund të ekzekutohet as në mënyra te tjera te parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-së, do të ekzekutohet ne atë mënyrë që i pandehuri për çdo 20 Euro, do të vuaj 1 /një/ ditë burgimi.
- Te dëmtuarën DBP-Ferizaj ne emër të kërkesës pasurore juridike, i pandehuri obligohet ti paguaj shumen prej 719.55 euro. .
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro, ne afat prej 30 ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

### A r s y e t i m

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2167-2/15 te dt. 19.04.2016, ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR] për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 të KPRK-së, prokurori i shtetit mbeti në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 04.01.2018, në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën penale që e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave, si dhe në dhënin e mendimit mbi pranimin e fajësisë shton se ndihet thelle i penduar, kërkojë falje publike, i premtoj gjykatës se me nuk do te përsëritet, lus gjykatën që të i shqipton një dënim sa me te but.*

Prokurori i Shtetit Sebahate Sinani duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësore, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 KPPK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 323 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit ne shqyrtimin fillestar si dhe fletëparaqitja e rojës se pyjeve nr. ditari 38/2016 dt. 15.11.2016, procesverbali mbi vlerësimin e demit Np.639/2016 i dt. 15.11.2016, si dhe prova te tjera te cilat gjenden ne shkresat e lendes, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.
- me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj trupi gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPP-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqyrtimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit, *(nëse*



*i pandeburi në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjyqës vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjyqës dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Gjykata pas administrimit dhe leximit të provave materiale në shqyrtim fillestar dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim: me datë 11.11.2016, rreth orës 16:00, në pyllin publik, në vendin e quajtur "Ngastra 61" në Rajonin Ekonomiko Pyjor, Neredime-Jezerce, me qëllim vjedhje është takuar duke prere kater /4/ cope trungje te ahut e te njohëm, me diametër 40-50 cm, me vëllim të përgjithshëm prej 5.33 metra kub, në vlerë prej 719.55 euro /shtatëqind e nëntëmbëdhjetë e pesëdhjetë e pesë cent/, drutë kanë qenë të prerë me sharrë motorrike dhe të transportuar me traktor të markës IMT.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi i akuzuarin me qëllim vjedhje dhe dashje direkt ka prerë drutë e njohme siç janë përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në atë mënyrë që i kanë shkaktuar dëme DBP-Ferizaj në shumën prej 719.55 euro me veprimet e tij dhe i vetëdijshëm për pasojat e tyre.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë lehtësuese përkatësisht që në fillim të shqyrtimit ka pranuar fajësinë, nuk ka dëshmi se është gjykuar me vendim të formes se prerë, pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer e që këto rrethana i ndërliidhi edhe me premtimin se me nuk do të përsërit këtë vepër, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes,

rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Të dëmtuarës DBP-Ferizaj ne emër të kërkesës pasurore juridike, i pandehuri obligohet ti paguaj shumën prej 719.55 euro. .

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro, ne afat prej 30 ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.


Nga arsyet e sipër cekura u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr.977/17 dt. 11.01.2018**

**Zyrtare ligjore**  
**Kadisha Shabani**

**Gjyqtari : Ilir BYTYQI**



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.